



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Agjencia e Kosovës për Akreditim
Agencija Kosova za Akreditaciju
Kosovo Accreditation Agency



Data: 10/01/22 Ref.: 42/22

Në mbështetje të nenit 8 dhe 12 të Ligjit për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura Republikës së Kosovës Nr.06/L-113 (Gazeta Zyrtare Nr.07/01 mars 2019), Ligjit për Procedurën e Përgjithshëm Administrative Nr. 05/L-31 (Gazeta Zyrtare Nr.20/12 Qershor 2016), Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës Nr. 04/L-037 (Gazeta Zyrtare Nr.14/9 Shtator 2011), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.15/2018, datë 28.09.2018), Manualit për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë, dhe të Vendimit të KShC-së, nr. 3236/21D të datës 21.09.2021; Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KSHC), në mbledhjen e 94-të, të mbajtur më 21 dhjetor 2021, mori:

V E N D I M

- I. Refuzohet kërkesa e Kolegjit UBT, Dega në Ferizaj, Nr. 3516/21H datë 01.11.2021 për akreditim të programeve të studimit:
 1. Dizajn i Integruar, BA, 180 ECTS (Riakreditim);
 2. Infermieri, BSc, 180 ECTS (Akreditim);
 3. Sistemet e Informacionit, BSc, 180 ECTS (Akreditim).
- II. Refuzohet pjesërisht kërkesa e Kolegjit UBT, Dega në Ferizaj, Nr. 3516/21H datë 01.11.2021 për akreditim të specializimeve të programeve të studimit:
 4. Menaxhment, Biznes dhe Ekonomi, BSc, 180 ECTS (Riakreditim):
 - o Financat Bankare dhe Sigurime;
 - o Kontabilitet, Auditim dhe Tatim; dhe
 - o Menaxhim, Ndërmarrësi dhe Inovacioni.
- III. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

Arsyetimi

Kolegji UBT ka parashtruar kërkesë (Nr. 3424/21H datë 20.10.2021) pranë Agjencisë së Kosovës për Akreditim (AKA) për akreditim të programeve të studimit: 1. Inxhinieria e Energjisë dhe Menaxhment, Niveli V sipas KKK, 120 ECTS; 2. Inxhinieria e Energjisë dhe Menaxhment, BSc, 180 ECTS; 3. Shkenca Politike - Integrimi dhe Qeverisja, MA, 120 ECTS; 4. Juridik, Kriminologji Kompjuterike dhe Forenzikë, LLM, 60 ECTS; 5. Teknik i Anesteziologjisë, BSc, 180 ECTS; 6. Dizajn i Integruar, BA, 180 ECTS (Dega në Ferizaj); 7. Dizajn i Integruar, BA, 180 ECTS (Dega në Prizren); 8. Dizajn i Integruar, BA, 180 ECTS (Dega në Pejë); 9. Energjia Elektrike dhe Tregu i Energjisë, MSc, 120 ECTS; 10. Biznes dhe Teknologji, BA, 180 ECTS; 11. Infermieri, BSc, 180 ECTS (Dega në Ferizaj); 12. Mjekësi e përgjithshme, Dr. Med., 360 ECTS; 13. Dizajn Mode dhe Menaxhment, BA, 180 ECTS; 14. Bujqësia e Mençur dhe Mjedisi, BA, 180 ECTS; 15. Biznesi dhe Teknologjia, PhD, 180 ECTS; 16. Zhvillues të Softuerit dhe TI, Diplomë Profesionale, 180 ECTS (Dega në Pejë); 17. Sistemet e Informacionit, BSc, 180 ECTS (Dega në Ferizaj); 18. Menaxhment, Biznes dhe Ekonomi, BSc, 180 ECTS me tre (3) specializime (Dega në Ferizaj); dhe Menaxhment, Biznes dhe Ekonomi, BSc, 180 ECTS me tre (3) specializime (Dega në Gjiilan).

Bazuar në pikën 1.2 të Nenit 10 të UA për Akreditim ku thuhet, *"Në përputhje me kërkesat e këtij udhëzimi administrativ, KShC do të bëjë aprovimin e listës së stafit akademik për çdo program të studimit i cili parashtrohet për aplikim nga institucionet e arsimit të lartë. Tabelat e plotësuara në formë elektronike së bashku me deklaratat për angazhimin e stafit akademik përcillen në formë të raportit përmbledhës në mbledhjen e ardhshme të KShC-së për aprovim formal. Raporti përmbledhës për gjendjen e stofit në bazë të të dhënave të dorëzuara nga institucionet e arsimit të lartë përgatitet nga stafi i AKA-së"*, KShC në mbledhjen e mbajtur më 21 dhjetor 2021 ka trajtuar aplikacionin e dorëzuar nga ky Universitet.

Sipas të dhënave të prezantuara nga raporti përmbledhës për programet për të cilat ka aplikuar ky institucion, dhe pas analizimit të detajuar të dokumentacionit të prezantuar për stafin akademik, ashtu siç parashihet me Nenin 26, pika 5.3.4 e UA për Akreditim, dhe bazuar në Nenin 10, pika 1.3.2 të tij, KShC mori vendim për refuzim të aprovimit të aplikacionit për programet si në dispozitiv të këtij vendimi.

1. **Për programin Dizajn i Integruar, BA, 180 ECTS (Dega në Ferizaj)**, institucioni ka paraparë si bartës të programit: Sadije Kelmendi (MA në Arkitekturë dhe Planifikim Hapësinor), Artan Behluli (Inxhinier i Arkitekturës), Zana Prevlukaj (MA në Arkitekturë dhe Planifikim Hapësinor), Burim Berisha (MA në Skulpturë), Afërdita Statovci (MA në Modë), Muharrem Sejdiu (PhD në Përpunimin e Drurit) dhe Kaltrina Veseli - Shllaku (Master në Dizajn Grafik).

Sipas Nenit 26, pika 5.3.4 e UA për Akreditim, kërkohet që: *"Për programet e studimit të cilat shpijnë deri tek marrja e një diplome shkencore Bachelor dhe Master, kërkesat për stafin akademik janë që për çdo grup të studentëve (të përcaktuar sipas statutit të IAL) dhe për çdo 60 ECTS kredi të programit të studimit, institucioni duhet të ketë të paktën një (1) staf me marrëdhënie të rregullt të punës me titull PhD nga fusha e programit të studimeve"*.

Pas verifikimit të dokumentacionit ashtu siç është përcaktuar me Udhëzimin Administrativ 15/2018, KShC ka konstatuar se titujt akademik i bartëseve Sadije Kelmendi, Artan Behluli, Zana Prevlukaj, Burim Berisha, Afërdita Statovci, dhe Muharrem Sejdiu nuk përkojnë me fushën e programit të studimit.

Bazuar në faktet e prezantuara me sipër dhe dispozitat ligjore të sqaruara më lartë, KShC vendosi që në mungesë të stafit adekuat, dhe bazuar në Nenin 26, pika 5.3.4 e Udhëzimit Administrativ për Akreditim, dhe në vendimin e KSHC-së nr. 3236/21D të refuzoj aplikacionin për programin e studimit Dizajn i Integruar, BA, 180 ECTS.

2. **Për programin Infermieri, BSc, 180 ECTS**, institucioni ka paraparë si bartës të programit: Drenushë Zuka (MSc në Edukim në Kujdesin Shëndetësor), Nafije Pajaziti (MA në Infermieri), Drita Berisha (MA në Infermieri), Doruntina Zejnullahu (MSc në Edukim në Kujdesin Shëndetësor), dhe Muhamed Tairi (MSc në Menaxhim Infermior).

Sipas Nenit 26, pika 5.3.4 e UA për Akreditim, kërkohet që: *“Për programet e studimit të cilat shpijnë deri tek marrja e një diplome shkencore Bachelor dhe Master, kërkesat për stafin akademik janë që për çdo grup të studentëve (të përcaktuar sipas statutit të IAL) dhe për çdo 60 ECTS kredi të programit të studimit, institucioni duhet të ketë të paktën një (1) staf me marrëdhënie të rregullt të punës me titull PhD nga fusha e programit të studimeve”.*

Për shkak të mungesës së bartësve të programeve akademike me nivelin PhD, ashtu siç është e përcaktuar me UA për Akreditim 15/2018, dhe mungesës së publikimeve shkencore sipas vendimit të Këshillit Shtetëror të Cilësisë nr. 3236/21D të datës 21.09.2021 për plotësim e parimeve themelore të Manualit për Akreditim, pika 5.1 e tij, ku përcaktohet se: *Nga 1 tetori 2021, përveç kritereve të përcaktuara me UA për akreditim, bartësit e programeve që hyjnë në proces të akreditimit në nivel BA/BSc duhet të kenë të paktën 1 (një) publikim shkencor të indeksuar nga fusha e studimit/programit, ndërsa në nivelin MA/MSc duhet të kenë së paku 2 (dy) punime nga fusha e studimit/programit në revista shkencore të indeksuara si autor i parë apo korrespondent, sipas nenit 3, pika 1.1 WEB OF SCIENCE koleksioni bërthamë (SCIE, SSCI dhe AHCI), apo 1.2 SCOPUS, duke përjashtuar revistat ose shtëpitë botuese të dyshimta sipas UA 01/2018 të aprovuar nga MASHTI;*

dhe;

Pas verifikimit të dokumentacionit ashtu siç është përcaktuar me Udhëzimin Administrativ 15/2018, KShC ka konstatuar se institucioni ka deponuar dokumente të falsifikuara për bartësin Muhamed Tairi, i cili është vërtetuar se është i punësuar me orar të plotë në Republikën e Maqedonisë së Veriut;

Bazuar në faktet e prezantuara me sipër dhe dispozitat ligjore të sqaruara më lartë, KShC vendosi që në mungesë të stafit adekuat, deklarimit të falsifikuar nën betim dhe bazuar në Nenin 26, pika 5.3.4 e Udhëzimit Administrativ për Akreditim, dhe në vendimin e KSHC-së nr. 3236/21D të refuzojë aplikacionin për programin e studimit Infermieri, BSc, 180 ECTS.

3. **Për programin Sistemet e Informacionit, BSc, 180 ECTS (Akreditim)**, institucioni ka paraparë si bartës të programit: Agim Zuzaku (PhD në Teorinë e Menaxhimit të Informacionit dhe Njohurive), Agron Bislimi (PhD në Shkenca Teknike), Melinda Pacolli (PhD në Teknologji Informative), dhe Muhamet Gërvalla (PhD në Teknologji Informative).

Sipas Nenit 26, pika 5.3.4 e UA për Akreditim, kërkohet që: *“Për programet e studimit të cilat shpijnë deri tek marrja e një diplome shkencore Bachelor dhe Master, kërkesat për stafin akademik janë që për çdo*

grup të studentëve (të përcaktuar sipas statutit të IAL) dhe për çdo 60 ECTS kredi të programit të studimit, institucioni duhet të ketë të paktën një (1) staf me marrëdhënie të rregullt të punës me titull PhD nga fusha e programit të studimeve".

Pas verifikimit të dokumentacionit ashtu siç është përcaktuar me Udhëzimin Administrativ 15/2018, KShC ka konstatuar se bartësit nuk plotësojnë kriterin e publikimeve shkencore sipas vendimit të Këshillit Shtetëror të Cilësisë nr. 3236/21D të datës 21.09.2021 për plotësim e parimeve themelore të Manualit për Akreditim, pika 5.1 e tij, ku përcaktohet se: *Nga 1 tetori 2021, përveç kriterëve të përcaktuara me UA për akreditim, bartësit e programeve që hyjnë në proces të akreditimit në nivel BA/BSc duhet të kenë të paktën 1 (një) publikim shkencor të indeksuar nga fusha e studimit/programit, ndërsa në nivelin MA/MSc duhet të kenë së paku 2 (dy) punime nga fusha e studimit/programit në revista shkencore të indeksuara si autor i parë apo korrespondent, sipas nenit 3, pika 1.1 WEB OF SCIENCE koleksioni bërthamë (SCIE, SSCI dhe AHCI), apo 1.2 SCOPUS, duke përjashtuar revistat ose shtëpitë botuese të dyshimta sipas UA 01/2018 të aprovuar nga MASHTI;*

Gjithashtu bartësja e programit Melinda Pacolli ka deponuar nostrifikim të pa vulosur dhe pa protokoluar në sistemin e-Akreditimi;

Bazuar në faktet e prezantuara me sipër dhe dispozitat ligjore të sqaruara më lartë, KShC vendosi që në mungesë të stafit adekuat, dhe bazuar në Nenin 26, pika 5.3.4 e Udhëzimit Administrativ për Akreditim, dhe në vendimin e KSHC-së nr. 3236/21D të refuzojë aprovimin e aplikacionit për programin e studimit Sistemet e Informacionit, BSc, 180 ECTS (Akreditim).

4. **Për programin Menaxhment, Biznes dhe Ekonomi, BSc, 180 ECTS me tre (3) specializime (Riakreditim)**, institucioni ka paraparë si bartës të programit: Kestrim Avdimetaj (PhD në Ekonomi), Labeat Mustafa (PhD në Menaxhment), Burhan Rexhepi (PhD në Administrim Biznesi), Enver Daci (PhD në Menaxhment) dhe Gëzim Jusufi.

Sipas Nenit 26, pika 5.3.4 e UA për Akreditim, kërkohet që: *"Për programet e studimit të cilat shpijnë deri tek marrja e një diplome shkencore Bachelor dhe Master, kërkesat për stafin akademik janë që për çdo grup të studentëve (të përcaktuar sipas statutit të IAL) dhe për çdo 60 ECTS kredi të programit të studimit, institucioni duhet të ketë të paktën një (1) staf me marrëdhënie të rregullt të punës me titull PhD nga fusha e programit të studimeve".*

Sipas pikës 5.3.5. të nenit 26 të UA për Akreditim, kërkohet që: *"Nëse programi i studimit përmban edhe specializime, atëherë numri i specializimeve duhet të jetë në përputhje me numrin e stafit akademik të rregullt me gradë akademike PhD, në atë program i cili ka kompetencën e duhur për ato specializime".* Ky program ka 180 ECTS dhe tri (3) specializime, dhe rrjedhimisht, sipas nenit 26, pika 5.3.4. dhe 5.3.5 të Udhëzimit Administrativ për Akreditim, për këtë program Kolegji UBT duhet të ketë së paku pesë (5) staf akademik me marrëdhënie të rregullt të punës me gradë shkencore PhD nga fusha e programit të studimit.

Pas verifikimit të dokumentacionit ashtu siç është përcaktuar me Udhëzimin Administrativ 15/2018, KShC ka konstatuar se bartësit Burhan Rexhepi dhe Gëzim Jusufi nuk plotësojnë kërkesat e parapara sepse Burhan Rexhepi, sipas ATK figuron si i punësuar me orar të plotë në dy vende të punës, kurse Gëzim Jusufi nuk e ka kompletuar deklarinimin dhe ngarkimin e dokumenteve të kërkuara sipas UA 15/2018 në platformën e-Akreditimi.

Bazuar në kërkesën për akreditim të këtij programi të studimit, në të cilën Kolegji UBT ka plotësuar kriterin për tre (3) bartës të programit të studimit, e jo pesë (5) siç kërkohet me UA për Akreditim, prandaj KShC në mbledhjen e 94 të mbajtur më 21.12.2021, pas shqyrtimit të aplikacionit, ka konstatuar se stafi akademik i prezantuar nuk është i mjaftueshëm për mbulimin e specializimeve të programit të studimit, dhe si rezultat ka vendosur për refuzimin e specializimeve si në pikën II të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi mund të paraqitet ankesë sipas Nenit 125 dhe 126 të Ligjit mbi Procedurën e Përgjithshme Administrative (Nr. 05/L-031, datë 25 Maj 2016). Ankesa kundër këtij akti administrativ i dorëzohet organit të Komisionit të Ankesave të AKA-së, sipas Rregullores nr. 2/2019, në afatin prej 30 ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ sipas Nenit 127 të LPPA.

Vendimi iu dërgohet:

- Kolegjit “UBT”, dega në Ferizaj
- MASHTI;
- Arkivit të AKA-së.


Prof. Ass. Dr. Hasnija Ilazi
Kryetare e Këshillit Shërbëtor të Çështjeve

